

1082

06.02.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 2011 prot.
3

Elbasan, më 21 . 2 .2025

Lënda: Konfirmim akti.

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.10 datë 31.01.2025" Për nxjerrjen nga përdorimi dhe prishje të murit të rrënuar në objektin me nr.pasurie 1/99 Z.K.2446 me emërtim Ndërtesa e zyrave të nd.Ujrave dhe sip. Funksionale zona ekon qytetit, Bashkia Librazhd dhe vazhdimin e projektit "Qendra Shëndetësore Librazhd" dhe pasi u njohëm me të dhënat plotësuese të dërguara në institucionin tonë me shkresën me Nr. 941 prot, datë 17.02.2025, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
AL MYSLIU

201
04.2.2025
REPUBLICA E SHQIPËRISE
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK



REPUBLICA E SHQIPËRISE
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.04.02.2025

Nr. 677 prot

Nr.10 dt.31.01.2025

**“PËR NXJERRJE NGA PËRDORIMI DHE PRISHJE TË MURIT TË RRËNUAR
NË OBJEKTIN ME NR. PASURIE 1/99 , Z.K. 2446 ,me emërtim “Ndërtesa e Zyrave
të nd.Ujrave dhe sip Funksionale, Zona Ekon. Qytetit, Bashkia Librazhd”, dhe
vazhdimin e projektit “Qendra Shëndetësore Librazhd.**

Mbeshtetur në :Ligjin Nr.139 Date 17.12.2015 “ Për Vetqeverisjen Vendore “ , neni 54 “Kompetencat e Kryetarit “ Ne Ligjin 10296 Date 10.07.2010 “Per menaxhimin Financiar dhe Kontrollin “, në Udhezimin e Ministrise se Financave Nr.30 Date 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve ne Njesite e Sektorit Publik “,pika 103/h dhe pika 118.1” , ne Manualin per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me Urdher te Ministrit te Financave Nr.8980, date 15.07.2010 ,i ndryshuar ,ne Ligjin Nr.9228 Date 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare “, ndryshuar me Ligjin Nr.9477 Date 9.02.2006,Këshilli Bashkiak I mbledhur sot më date 31.01.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit dhe prishjen e murit të rrënuar/amortizuar në objektin me numer pasurie 1 /99 , ZK 2446, Pronë me certifikate nga Bashkia Librazhd, me emertim “Ndertesa e Zyrave të nd.Ujrave dhe sip Funksionale Zona Ekon Qytetit Bashkia Librazhd”.Për arsye se mbi këtë truall , do të ndërtohet objekti “Qendra Shëndetësore Librazhd”, me sipërfaqe 200 m2, që do të vecohet nga sip.totale 3082 m2 e pronës.
2. Ndjek zbatimin e këtij P/vendimi ,Saktori Aseteve, Saktori Juridik,Saktori i Finances
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU



RELACION

“PER

NXJERRJE NGA PERDORIMI DHE PRISHJE TË MURIT TË RRËNUAR NË OBJEKTITIN ME NR. PASURIE 1/99 , Z.K. 2446 ,ME EMERTIM “Ndertesa e Zyrave te nd.Ujrave dhe sip Funksionale, Zona Ekon Qytetit Bashkia Librazhd” DHE VAZHDIMIN E PROJEKTIT “QËNDRA SHËNDETESORE LIBRAZHD”. Prone me Certificate nga Bashkia Librazhd.

Të nderuar Këshilltare !

Në pasurinë me Nr. 1/99, Z.K 2446, prone me Certificate nga Bashkia Librazhd, ku jane ambientet e MZSH-se, është menduar që të ndërtohet “Qendra Shëndetsore Librazhd”

Kjo prone që do zhvillohet ka nje siperfaqe prej 200 m2, (Kjo siperfaqe do të vecohet nga Siperfaqja totale e pronës prej 3082 m2, që është shënuar në certifikaten e pronësise)

Zona ku parashikohet të ndërtohet objekti ka nje situate jo shume te zhvilluar, përpalle ka nje park rekreativ, dhe perrreth ka objekte të tipit zjarrfikse etj. Objekti kufizohet ne ktahun jugor nga nje objekt 2 katesh, në krahun verior nga një objekt 2 katësh, dhe nga ana perëndimore nga rruga. Nga pikpamja topografike zona është e rrafshet.

Kerkohet nxjerrja nga përdorimi dhe prishja e një muri të rrënuar/amortizuar, pjesë e sipërfaqes ku do te zhvillohet projekti, dhe ndryshimi statusit te prones prej 200 m2 , nga listat e inventarit.

Bashkangjitur Certificate e pronësise së Bashkisë Librazhd.

Spektori I Aseteve

Jetmir Vreto

